

VENDIM
Nr. 266, datë 27.10.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“DRAGOBIA ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2516/2 prot., datë 23.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Dragobia Energy’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

- konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2516/1 prot., datë 16.10.2025, shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike ,

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo me vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Rezulton se shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 16.4.2021 (data e përfundimit të licencës nr. 488, seria F21, është 16.4.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 16.10.2025.

- Sa konstatohet, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa u përket pagesave të rregullimit.

- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të rregullores, vlerësohet se nga shoqëria duhet të depozitohet dhe sa vijon:

- Shoqëria duhet të depozitojë vendimin e organeve drejtuese, ku të përcaktohet qartë se shuma e fondeve të nevojshme për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj, do të dedikohet posaçërisht për këtë qëllim.

- Shoqëria duhet të sqarojë mënyrën e sigurimit të zyrave përfaqësuese për periudhën e mbetur të vlefshmërisë së licencës, që kërkon të rinovohet, duke qenë se kontrata aktuale e huapërdorjes është e vlefshme vetëm deri më datë 29.7.2027 dhe nuk mbulon të gjithë afatin 5-vjeçar të licencës pas rinovimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 16.4.2021.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti